

INVESTIMET E ARNUARA

COPYRIGHT © 2017.Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur - KFOS. Opinionet, të gjeturat dhe rekomandimet në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

**ANALIZË MBI PASOJAT EKONOMIKE QË
DALIN NGA MUNGESA E VLERËSIMIT
TË PERFORMANCËS SË OPERATORËVE
EKONOMIKË NË PROKURIMIN PUBLIK**

TETOR 2017

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
REKOMANDIME.....	7
LISTA E SHKURTESAVE	8
HYRJE	9
METODOLOGJIA.....	11
ANALIZA	12
Mungesa e vlerësimit të kontratave publike sjell dëme te qytetarët – raste të hulumtuara	12
Rasti 1: Ndërtimi i 25 shkollave model nga Ministria E Arsimit, Shkencës Dhe Teknologjisë	13
1.1. Shkolla Fillore “Tefik Çanga” Ferizaj.....	13
1.2. Shkolla Ekonomike “Faik Konica” Ferizaj.....	14
Rasti 2: Parku i Biznesit Drenas	16
Raste të tjera të humbjes të parasë publike nga menaxhimi i dobët i kontratave	19
DISPOZITAT LIGJORE	23
KONKLUZIONE.....	25

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qytetarët e Kosovës vazhdojnë që të përballen me kualitet të dobët të shërbimeve dhe investimeve të blera nga Institucionet përmes prokurimit publik si pasojë e menaxhimit të dobët nga autoritetet kontraktuese dhe kualitetit të dobët të punëve apo produkteve të liferuara nga kontraktorët. Kjo, në raste të shumta rrjedh nga mos përmbushja e obligimeve kontraktuale si nga institucionet, po ashtu edhe nga bizneset. Kjo vjen si pasojë e tenderimeve me çmime tejet të ulëta, ku nuk bëhet një përlllogaritje e drejtë e kostos dhe marzhës së fitimit, por ofertohet me çmime tejet të ulëta vetëm sa për të fituar punën. Operatorët ekonomik vazhdojnë të ndjekin këtë trend për të qenë sa më konkurrues në tregun e kontratave publike, ndërkohë që Autoritetet Kontraktuese vetëm sa e stimulojnë atë duke mos aplikuar masa të vazhdueshme të menaxhimit të kontratave, duke mos

Menaxhimi i dobët i kontratave publike po i kushton tatimpaguesve kosovarë në kualitetin por edhe në koston e shërbimeve, meqë jo pak herë, Autoritetet Kontraktuese janë dashur të japin kontrata të reja për të “arnuar” investimet paraprake, në vend se të bëhej ndonjë investim i ri në ndonjë segment tjetër që do të përmirësonte jetën e qytetarëve.

aplikuar sigurimet e kontratës, apo penalizuar kompanitë për mos-performancë. Kjo analizë e shpërfaqë menaxhimin e dobët të disa kontratave publike, respektivisht kualitetin e dobët të investimeve kapitale, të cilat llogariten si ndër

investimet me koston, jetëgjatësinë, qëndrueshmërinë, dhe vizibilitetin më të lartë, ku investuesi kryesor është taksapaguesi ndërsa përfituesi kryesor është qytetari. Investimet kapitale përbëjnë kontratat më të kushtueshme si në koston afatshkurtër (ndërtimi apo riparimi) po ashtu edhe në atë afatgjatë (mirëmbajtja). Edhe pse, këto investime janë shumë të kushtueshme, ato janë shumë të nevojshme për mirëqenien dhe kualitetin e jetës së qytetarit. Kur këto investime dhe kontrata nuk menaxhohen si duhen, barra bie mbi xhepin e qytetarit, duke krijuar nevojën për shpenzime sht-

esë që rëndojnë buxhetin, mirëqenien dhe shëndetin publik.

Për studim të problemit, janë hulumtuar tri investime: Parku i Biznesit në Drenas, dhe dy shkolla fillore të komunës së Ferizajt, “Faik Konica” dhe “Tefik Çanga”.

Fshati Koreticë e Epërme, rreth 2 km afër Parkut të Biznesit në Drenas, ballafaqohet me mungesë të ujit të pijshëm, me ndotje të ambientit, probleme këto të shfaqura pas krijimi të këtij Parku. Hulumtimi nga tereni tregon se ky park është dëshmia më e mirë se punimet e pafinalizuara siç duhet, vazhdojnë t’u shkaktojnë probleme të mëdha qytetarëve. Shpresa se funksionalizimi i një parku të tillë do t’u siguronte më shumë punë banorëve, u kthye në zhgënjim tash e tri vite duke ua prishur banorëve dy nga katër elementet esenciale për jetë: ujin dhe ajrin!

Në Ferizaj janë dy objekte shkollore të reja, që nga jashtë të krijojnë përshtypjen e objekteve të standardeve evropiane, por me të hyrë brenda, niveli i punëve të kryera shpërfaqë defektet e ndërtimit ku nuk janë respektuar standardet themelore. Kur ka të reshura objekti mbushet me ujë nga rrjedha që vie nga çatia dhe dritaret. Lagështia e krijuar përbën rrezik për rrëshqitje për nxënësit dhe personelin. Në klasët afër toaleteve, era e mykut e krijuar nga lagështia si pasojë e instalimit të dobët të gypave të ujës jellësit, të ndalë frymën. Gjatë stinës së dimrit mungon ngrohja e nevojshme për mësimnxënie, për shkak të instalimit të dobët të sistemit të ngrohjes qendrore.

Të dy këto shkolla “Faik Konica” dhe “Tefik Çanga”, ku vijojnë mësimet mbi 2,500 nxënës, kanë probleme të ngjashme dhe janë të ndërtuara nga po e njëjta kompani. Shkolla “Faik Konica”, edhe pse ka vetëm një vit pune në këtë objekt, për shkak të mbikëqyrjes së dobët nga MASHT-i gjatë kryerjes së punëve ka qaq shumë probleme të cilat vështirësojnë mbarëvajtjen e mësimin. Në anën tjetër shkolla “Tefik Çanga” pas 7 viteve, duke kërkuar çdo vit të adresohen kushtet e rënda të punës, më në fund sivjet ka përfituar riparime shtesë, të cilat nuk i kanë evituar të gjitha problemet. Ndërkohë zgjidhja e këtij problemi ka sjellë kosto shtesë për komunën e cila është dashur të riinstalojë ngrohjen qendrore për të mos u ndërprerë procesi mësimorë.

Neni 62 i Ligjit për Prokurim Publik¹ definon dispozitat për aktivitetet e menaxhimit të kontratës, megjithatë, ky nen nuk adresohet në mënyrë adekuate, duke marr parasysh se institucionet nuk mobilizojnë ekipe të menaxhimit të kontratës po një menaxher, mbi supet e të cilit bien të gjitha aktivitetet e kontratës².

Një menaxher nuk mund të konsiderohet ekspert i të gjitha fushave, gjithashtu koncentrimi i të gjitha përgjegjësive në një person, rritë gjasat për korrupsion. Në vijim, si një vegël për kontroll të kualitetit, neni 63 i LPP-së parasheh sigurimin i ekzekutimit (garancinë e kontratës), e cila do të konfiskohet në rast se kontraktori i shkel kushtet e kontratës.

1 LIGJI NR. 05/L-092 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068

2 E njëjta definohet edhe në Ligjin Nr. 03/L-241, Neni 81, Aktivitetet e Menaxhimit të Kontratës, i cili ishte në fuqi në kohën e dhënies së kontratave në fjalë, dhe i cili është shfuqizuar nga Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës (<http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-241-alb.pdf>)

Sigurimi i ekzekutimit është parakusht për nënshkrimin dhe hyrjen në fuqi të kontratës, që është 10% i vlerës së kontratës dhe në rast që kontrata nuk përmbushet kjo shumë konfiskohet në tërësi apo një pjesë e saj sipas llogaritjes së dëmeve të shkaktuara³.

Hulumtimi ka evidentuar se pavarësisht që është bërë pranimi teknik i punëve, funksionimi i objekteve ka pasur probleme që në vitin e parë të përdorimit. Këto nuk janë rastet e vetme për cilësi të dobët dhe ndërprerje të punimeve. Palestra e sporteve në komunën e Shtimes është projekt i filluar që shtatë vite nga MKRS, dhe ende është i papërfunduar. Ky fakt ka lënë klubet e ndryshme të këtij qyteti t'i kryejnë stërvitjet në ambiente të hapura dhe në shkolla ku ka palestra sportive, pas shumë ankesave nga

komuna finalizimi dhe riparimet e punëve për objektin e sallës sportive kanë filluar tash në vitin 2017 gjithashtu duke krijuar kosto shtesë për shkak të vjetërsisë së punimeve fillestare.

Në ndërkohë, sipas intervistave me afaristë që veprojnë në zonë⁴, raportimeve në media si dhe nga Instituti GAP, nga problemet me realizimin e projektit të Pllatosë në Kurriz, në Prishtinë, deri më tani kanë mbyllur vepërimtarinë 8 ndërmarrës.

Nëpërmjet këtij raporti KDI do t'i adresojë rekomandimet te të gjitha organizatat buxhetore që të jenë të vëmendshme në menaxhimin e kontratave dhe të sigurohen se përdorin anën ligjore t'i ndëshkojnë të gjithë OE të cilët i shkelin kushtet e kontratës.

3 Po ashtu edhe kjo kërkesë definohet edhe në Ligjin Nr. 03/L-241, Neni 61, Siguria e Ekzekutimit, i cili ishte në fuqi në kohën e dhënies së kontratave në fjalë, dhe i cili është shfuqizuar nga Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurim Publik në Republikën e Kosovës (<http://kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-241-alb.pdf>)

4 Intervista me ndërmarrës që veprojnë në Kurriz (identiteti i njohur për KDI), 18 tetor 2017.

REKOMANDIME

Të gjeturat e këtij hulumtimi shtrojnë urgjencën për të intervenuar në disa nivele, si atë legjislativ e procedural. Si rrjedhojë e këtij hulumtimi, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) rekomandon që:

1. Komisioni Rregulativ i Prokurimit Publik të filloj procedurat dhe hulumtimet për ndryshim/plotësim të ligjit dhe udhëzimeve administrative lidhur me:
 - a. procesin e menaxhimit të kontratave
 - b. procesin e menaxhimit të furnitorëve
 - c. procedurat për vlerësim dhe shpërblim/penalizim të Operatorëve Ekonomik për kontratat e përfunduara.
 - d. Procedurat për menaxhimin e marrëdhënieve me furnitorët.
 - e. KRPP të krijoj procedurat dhe të marr përsipër aprovimin e përzgjedhjes së menaxherit, apo ekipeve për menaxhimin e kontratës, sipas kompleksitetit të punës.
2. Institucionet të rrisin përgjegjshmërinë dhe rrespektimin e ligjit përmes aplikimit të sigurimit të kontratës për punët e pa kryera apo të një kualiteti të dobët, si një mjet i penalizimit të Operatorëve Ekonomik dhe kursimit të parasë publike;
3. Institucionet qeverisëse të bëjnë hapjen e të dhënave, të cilat do të ndihmonin në angazhimin aktiv të qytetarit në identifikimin e problemeve dhe rritjen e llogaridhënies institucionale dhe afariste në humbjen e parasë publike përmes mjeteve për llogaridhënien sociale.
4. Menaxherët e kontratave të mbahen përgjegjës për menaxhim të dobët, konform dispozitave ligjore për nëpunës civil.
5. Komisioni i pranimit teknik të mbahet përgjegjës për punët e pranuar në përfundim të një projekti.

LISTA E SHKURTESAVE

- AK** – Autoriteti Kontraktues
- DKA** – Drejtoria Komunale e Arsimit
- DKRS** – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sporte
- KDI** – Instituti Demokratik i Kosovës
- KRPP** – Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- LPP** – Ligji për Prokurim Publik
- MASHT** – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
- MTI** – Ministria e Tregëtisë dhe Industrisë
- MKRS** – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
- MMHP** – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinorë
- OE** – Operatori Ekonomik
- OJQ** – Organizata Jo-Qeveritare
- OSHC** – Organizata të Shoqërisë Civile
- PBD** – Parku i Biznesit Drenas
- ZKA** – Zyra Kombëtare e Auditimit

HYRJE

Qëllimi i këtij raporti është të analizoj pasojat që vuan qytetari nga punimet e dobëta gjatë implementimit të kontratave publike, si dhe të dëshmojë se kontrolli dhe menaxhimi i punimeve duhet patjetër të adresohet.

Ky raport përmes analizës së kontratave, gjendjes së investimeve kapitale, dhe dëshmimeve të qytetarëve, tregon se si dëmet e shkaktuara mbeten të pa-kompenzuara, dhe shkaktajnë pasoja afatgjate si në shëndetin, po ashtu edhe në buxhetin familjar. Raporti pasqyron edhe problemet mbi pranimin teknik të projekteve që është vetëm formalitet, mbikëqyrja e punëve nga menaxherët e projekteve ende nuk e ka arritur seriozitetin e duhur, dhe se Operatorët Ekonomik nuk ndëshkohen për performancën e ulët. I vetmi akter në këtë proces, që ndëshkohet me kosto të rritur familjare, është qytetari i Kosovës!

Tash e sa vite, hulumtimet e shumta si nga Organizatat e Shoqërisë Civile, po ashtu edhe mediat e pavarura dhe Zyra Kombëtare e Auditimit, kanë evidentuar me qindra raste të shkeljeve të kushteve të kontratave dhe neglizhimin e kualitetit nga OE, të cilët vazhdojnë të mos ndëshkohen dhe të mbahen përgjegjës për këto shkelje. Aq më keq, në mungesë të dispozitave ligjore për vlerësimin e performancës së kontratës, këta OE, jo vetëm që nuk ndëshkohen, por vazhdojnë të shpërblehen me kontrata të reja publike.

Një vlerësim i tillë do të ndikonte në vetëdijesimin e Operatorëve Ekonomik si dhe do të bënte Autoritetet Kontraktuese të ishin më përgjegjëse në miratimin e punëve të kontraktuara dhe kontraktimin e punëve të ardhme. Agjencitë qeveritare mbështeten në kontraktorët për të kryer një gamë të gjerë të aktiviteteve të nevojshme për të përmbushur misionet e tyre. Vlerësimi dhe mbledhja e informacionit mbi punën e kontraktorit janë një mjet për të mbrojtur qeverinë (përfundimisht qytetarin) nga performanca e ulët, dhe për të mundësuar shpërblimin e kontraktorëve të mirë me punë të mëtutjeshme. Kjo ndihmon për t'u siguruar se qeveria bën biznes me kompanitë, të cilat japin

KDI beson se, tani, kur institucionet po kalojnë në një fazë më të avancuar të prokurimit publik, do të ishte e lehtë dhe e arsyeshme që të krijohej një sistem i vlerësimit të performancës së kontratave nga Zyra e Prokurimit, Zyra e Financave dhe Zyra e Menaxhimit të Kontratave, dhe duke përdorur shembuj ekzistues nga shtetet evropiane apo edhe më gjerë, të dëshmuara si të suksesshme, të krijohej një platformë e re, e mbështetur nga një legjislacion sekondar, si pjesë e menaxhimit të kontratës.

mallra dhe shërbime cilësore në kohë dhe brenda buxhetit dhe gjithashtu ndihmon në përmirësim të kualitetit në kontratat aktuale. Po ashtu, me një theks të veçantë në kontratat afatgjata, është një mënyrë e mirë për të siguruar se kontraktori e kupton plotësisht atë që qeveria dëshiron dhe mund të përmirësojmë qasjen e tij/saj drejt

përbushjes së suksesshme të obligimeve kontraktuale. Gjithashtu, vlerësimi i performancës shërben si bazë për përcaktimin e çmimeve reale dhe siguron informacionin e nevojshëm për zyrtarin kontraktues për të mbështetur vendimet për kontraktorët e mundshëm.

METODOLOGJIA

Metodologjia e hulumtimit të këtij raporti ka qenë e kombinuar, me një theks në një analizë cilësore, përmes aplikimit të burimeve primare si analizat e dokumentacionit, intervista me qytetarë dhe njohës të fushës, grupe fokusi si dhe burimet dytësore përmes shqyrtimit të literaturës (analizave dhe raportimeve ekzistuese), të cilat janë të njohura për qytetarin.

KDI ka përzgjedhur disa projekte kapitale më vlera të mëdha, të cilat veçse janë të njohura për publikun si përmes raportimeve nga mediat, por edhe nga ankesat e qytetarëve, si pjesë e hulumtimit, duke u fokusuar kryesisht në cilësinë e punimeve të realizuara. Hulumtimet nga tereni dhe vëzhgimi i këtyre projekteve kanë dëshmuar se menaxhimi dhe mbikëqyrja e punëve për projektet e përzgjedhura për hulumtim nuk janë zbatuar konform kushteve të kontratatave.

Intervistat me qytetarët janë pjesa më e rëndësishme e hulumtimeve tona, qytetari është dëshmitari më i mirë për të treguar gjendjen faktike duke e pasur parasysh që ai çdo ditë ballafaqohet me punën e dështuar të institucioneve apo mos realizimin e kontratës.

Intervistat me zyrtarët institucional po ashtu kanë qenë të pashmangshme për hulumtimet tona, sepse përgjegjësia kryesore e punimeve të dobëta bie mbi ta.

Gjithashtu, për çështje pasqyrimi të një situate të rëndë në implementimin e kontratave, KDI i është referuar edhe një sërë raportimesh nga mediat dhe Organizatat e Shoqërisë Civile, të cilat pasqyrojnë gjendjen e këtyre investimeve dhe problemet me të cilat po ballafaqohen qytetarët lidhur me këto investime.

KDI përmes Qasjes në Dokumente Publike ka analizuar dosjet e tenderit, ofertat e OE të 'shpërblyer' me kontrata, ditarin e menaxhimit të kontratave, vlerësimin e pranimit teknik të objekteve si dhe faturat e paguara për secilin situacion të kontratave që janë pjesë e hulumtimit.

Në kuadër të hulumtimit është organizuar grupi i fokusit me OJQ-të qëllimi i të cilit ka qenë kontributi i tyre dhe ndarja e përvojave nga fusha e prokurimit publik konkretisht të metat e implementimit të kontratave dhe dëmet e shkaktuara nga punimet e dobëta në projekte infrastrukturore.

ANALIZA

MUNGESA E VLERËSIMIT TË KONTRATAVE PUBLIKE SJELL DËME TE QYTETARËT – RASTE TË HULUMTUARA

Rastet e hulumtuara nga tereni janë dy shkollat në komunën e Ferizajt, të cilat ballafaqohen me pothuajse të njëjtat probleme teknike si rezultat i punës së dobët. Po ashtu, si rast studimi, janë marr problemet dhe pasojat të cilat po i bartë qytetari si pasojë e një kontrate të realizuar dobët në ndërtimin e Parkut të Biznesit në Drenas.

Arsyeja pse janë zgjedhur këto dy shkolla nuk kanë qenë rastësi, Shkolla e Mesme Ekonomike “Faik Konica” në Ferizaj dhe Shkolla Fillore “Tefik Çanga” po ashtu nga Ferizaj, në vitin e parë të punës kanë pasur probleme me objekt dhe që të dyja janë ndërtuar nga kompania e njejtë.

Kompania e cila ka ndërtuar këto dy shkolla, ka ndërtuar dhe ka riparuar edhe katër shkolla

tjera, dhe të gjitha së bashku i kanë kushtuar buxhetit të Kosovës 4,999,621.59 €^{5 6 7 8 9 10 11}

Në anën tjetër Parku i Biznesit në Drenas ende vazhdon të ketë probleme me rrjetin e kanalizimit dhe trajtimin e ujërave të zeza. Ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujrave të zeza i ka kushtuar buxhetit të Kosovës 611,866.26 €^{12 13 14} dhe problemet ende nuk janë evituar, e nga këto problem kanë pësuar qytetarët të cilët ballafaqohen me ndotje të ujit dhe të ajrit.

KDI ka vizituar për së afërmi këto projekte, pas krahasimit të punëve të kryera, të cilat nuk janë përputhur me kushtet e kontraktuara, ka gjetur humbjen e disa mijëra eurove të buxhetit nga punimet e pa përfunduara dhe pastaj nga riparimet e tyre.

5 Njoftim për dhënie të kontratës, MASHT208-08-043-5-1-1, data 19.06.2008 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=7749>

6 Njoftim për dhënie të kontratës, MASHT208-08-046-5-1-1, data 26.06.2008 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=7899>

7 Njoftim për dhënie të kontratës, MASHT208-08-101-5-1-1, data 18.10.2008 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=12012>

8 Njoftim për dhënie të kontratës, MASHT208-09-096-5-2-1, data 07.09.2009; <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=22549>

9 Njoftim për dhënie të kontratës, MASHT208-09-120-5-1, data 09.10.2009 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=24038>

10 Njoftim për dhënie të kontratës, MASHT208-12-064-5-2-1, data 12.10.2012 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=24038>

11 Referoju dokumentit hard copy për tenderin Njoftim për dhënie të kontratës, MTI204-09-096-5-1-1, data 16.10.2009 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=24283>

12 Njoftim për dhënie të kontratës, MTI204-10-055-5-2-1, data 17.06.2010 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=32114>

13 Njoftim për dhënie të kontratës, MTI204-15-008-5-2-5, data 08.07.2015 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=102467>

14 Njoftim për dhënie të kontratës, MTI204-09-088-5-1-1, data 15.07.2014 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=22929>

Në vitin 2017 MASHT-i më në fund kishte lidhur kontratë të re për sanimin e dëmeve në shkollën "Tefik Çanga" Ferizaj në vlerë prej 38,827.90 €²⁰.

Gjatë vizitës së ekipit të KDI-së në shkollën "Tefik Çanga", në një intervistë në me punëkryesin e sanimeve të dëmeve është kuptuar se me vlerën e kontraktuar prej 38,827.90 € nuk mund të riparoheshin të gjitha dëmet por vetëm disa prej tyre. Sipas kushteve të kontratës për sanimin e dëmeve, ishte kërkuar izolimi i kulmit, që kishte munguar paraprakisht, vendosja e ulluqeve, të cilët kishin munguar në disa pjesë të çatisë, lyerja e objektit brenda dhe jashtë si dhe riparimi i disa gypave të ujit²¹. Poashtu, është vërejtur se kjo shkollë kishte edhe probleme tjera si instalimi i dobët i gypave të ujit, nga të cilët kishte rrjedhje të vazhdueshme të ujit. Këto probleme vëreheshin edhe në muret e mykura, jo vetëm të banjove, por edhe në korridore dhe në klasët e mësimi që ishin afër banjove²². Sipas drejtorisë së shkollës, instalimi i ri i njejeve sanitare nëpër banjo do të investohet nga DKA e Ferizajt.

Për kontratën në fjalë, MASHT nuk është përgjigjur në kërkesën e KDI-së për Qasje në Dokumente Publike²³, me qëllim të analizimit të pagesave dhe vërtetimit nëse është ekzekutuar siguria e kontratës për punët e pa kryera, apo të kryera dobët.

1.2. Shkolla Ekonomike "Faik Konica" Ferizaj

Shkolla e mesme ekonomike "Faik Konica" në Ferizaj është një tjetër objekt, i cili është marr si subjekt trajtimi për këtë analizë. Kjo shkollë ishte përruruar më 05 shtator të vitit 2016²⁴.

Projekti i ndërtimit të kësaj shkolle ishte në vitin 2009, nga MASHT, në vlerë prej 1,964,354.43 €²⁵.

Ky objekt, që nga viti i parë i funksionalizimit ishte ballafaquar me probleme teknike nga më të ndryshmet si pasojë e kualitetit të dobët të ndërtimit. Problemet në këtë shkollë mund të vendosen në një listë të gjatë, duke filluar me instalimin e dobët të rrjetit të ujësjellësit, instalimin e dobët të ngrohjes qendrore, rrjedhje nga çatia dhe një sërë problemesh tjera. Ekipi i KDI-së ka vizituar edhe këtë shkollë²⁶ dhe për së afërmi ka evidentuar dëmet e shkaktuara nga punimet e dobëta të punëkryesit. Shkolla ka vetëm një vit që është funksionalizuar, e dëmet janë kaq të mëdha sa që qeverisja komunale ose qendrore duhet të realizojë investime shtesë për t'i riparuar dëmet e shkaktuata nga puna e keqe nga OE dhe mungesa e përgjegjësisë së mbikëqyrësve të projektit.

Gjatë intervistës, drejtori i kësaj shkolle ka potencuar se para fillimit të mbajtjes së procesit mësimor për vitin 2016/2017, ata kanë evidentuar të gjitha të metat e objektit.

Lloji i Punës	Vlera
Ndërtimi i shkollës	1,182,589.11 €
Riparimi i ngrohjes qendrore	16,392 €
Riparimi i kulmit dhe dëmeve tjera	38,827.90 €
TOTAL KOSTOJA SHITESË PËR ARNIMIN E INVESTIMEVE	55,220.00 €

20 Njoftim për dhënie të kontratës. MASHT208-17-003-5-2-1, data 11.05.2017. <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=139835>

21 Vizitë në shkollën "Tefik Çanga", intervistë me punëkryesin e sanimit të dëmeve, Ferizaj, data 21.08.2017

22 Sipas Specialistit të otorinolaringologjisë ORL, Dr. Ilir Ilazi, myku në disa raste është shumë i dëmshëm për organizmin e njeriut varësisht prej imunitetit të tij, te disa persona myku nuk paraqet probleme të mnëdha, por te disa të tjerë ngacmon organet e frymarjes, te disa shkakton alegji, dhe janë shumë të rrezikshme, sidomos kur qëndrohet gjatë në një ambient të tillë.

23 Kërkesë për qasje në dokumente publike, e dërguar me 16.08.2017

Ai po ashtu ka potencuar se deri më tani, ai nuk ka pranuar asnjë procesverbal nga ndonjë komision mbi pranimet teknike të objektit²⁷. Disa nga problemet të cilat i ka shkolla "Faik Konica", i ka edhe shkolla "Tefik Çanga".

Rrjeti i dobët i ujës-jellës-it- rrjedhja e ujit jashtë tubacioneve kishte shkaktuar lagështi, pasoja e të cilës shihej me rënjen e llaqit nga muri branda objektit si dhe erën e mykut që ishte shkaktuar nga lagështia e madhe.

Instalimi i dobët i ngrohjes qendrore- Sipas administratës së shkollës, si pasojë e instalimit të dobët të ngrohjes qendrore, gjatë stinës së dimrit kur fillon përdorimi i ngrohjes, jashtë gypave ka rrjedhje të ujit si dhe nxehtësia nuk shkon në disa radiator. Disa ambiente brenda shkollës, duke e përfshirë edhe zyrën e drejtorit, janë të ftohta dhe të papërdorshme gjatë stinës së dimrit. Sipas mirëmbajtësve të objektit të shkollës rrjedhja e ujit jashtë gypave të ngrohjes qendrore u shkaktonte probleme me pompën përçuese, të cilën vazhdimisht duhet ta mbushin me ujë që ekziston rreziku se ajo mund të dëmtohet.

Kur flasim për nxemjen qendrore, problem nuk është vetëm rrjedhja jashtë gypave. Kaldaja e shkollës e lidhur me oxhakun ka probleme të vazhdueshme nga mos tërheqja e tymit, për pasojë i gjithë ambienti ku qëndron kaldaja është i nxirë nga tymi. Punëtorët e mirëmbajtjes janë deklaruar se tymi i vazhdueshëm që del nga kaldajado të ndikoj në shëndetin e tyre dhe se mungesa e ajrosjes dhe thithja e vazhdueshme e tymit, i cili në kushte normale do të duhet të shkarkohej përmes oxhakut jashtë objektit të kaldajes.

Gjithnjë sipas drejtorit të shkollës, me të filluar reshjet në vitin 2016, ka pasur rrjedhje të ujit brenda objektit të shkollës, vendosja e gabuar e ulluqeve kishte shkaktuar rrjedhjen e ujit edhe nëpër muret e jashtme të objektit ku vëreheshin njollat dhe plasaritjet në fasadë, dhe për pasojë nga kjo rrjedhje e kombinuar me kushtet klimatike (ngricat) mund të vijë deri tek shkatërrimi i fasadës dhe izolimit të objektit.

Pavarësisht problemeve që ka pasur shkolla "Tefik Çanga", dhe MASHT ka qenë në dijeni për to, kontratën e radhës ia ka besuar sërish kompanisë së njëjte, e cila jo që nuk është ndëshkuar për shkelje të kushteve kontraktuale por është 'shpërblyer' sërish me kontratë.

Ankesat e shumta të dërguara në MASHT përmes DKA-së Ferizaj nuk kanë sjellë ndonjë dobi për riparimin e dëmeve. Pas publikimit në media për problemet me të cilat ballafaqohej kjo shkollë, atë e kishin vizituar një komision nga MASHT-i dhe DKA e Ferizajt, megjithatë deri më tani nuk ka pasur ndonjë veprim²⁸ për të mitiguar gjendjen ekzistuese. Po ashtu si në rastin e sipër cekur, MASHT²⁹ nuk i është përgjigjur kërkesës për të na lejuar qasje në dokumente publike, për të parë ditarin e punimeve të plotësuar nga menaxheri i projektit me qëllim të analizimit nëse janë evidentuar ndonjë nga këto probleme dhe parregullsi nga menaxheri i kontratës.

24 <http://archive.koha.net/?id=8&l=131354>

25 Njoftim për dhënie të kontratës, MASHT208-09-120-5-1-1, data 09.10.2009 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=240387>

26 Vizitat në terren, të datave 15.08.2017, 21.08.2017 31.08.2017 dhe 04.09.2017

27 Intervistë me Drejtorin e shkollës së mesme ekonomike "Faik Konica" Ferizaj, data 21.08.2017

28 Takimi i me udhëheqës të shkollës 31.08.2017

29 Kërkesë për qasje në dokumente publike e dates 16.08.2017; MASHT është kontaktuar me telefon me 25.08.2017 dhe 31.08.2017

RASTI 2: PARKU I BIZNESIT DRENAS

Një histori tjetër e tejzgatur e një projekti infrastrukturorë me probleme, është edhe ndërtimi i Parkut të Biznesit në Drenas nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI). Qëllimi i këtij parku ishte rregullimi i infrastrukturës për investitorë të huaj dhe vendorë, me ç'rast nga këto investime do të përfitonin edhe qytetarët e asaj zone si individë potencial për t'u punësuar. Megjithatë, ata nga ardhja e tij pësuan dëme të mëdha materiale, pavarësisht që projekti kushtoi miliona euro.

Problemi më i madh, me të cilin ballafaqohen banorët e kësaj zone nga ndërtimi i këtij parku, është mos përfundimi i rrjetit të kanalizimit, që kishte shkaktuar dëme anësore, e me një theks të veçantë në furnizimin me ujë. Funksionimi i këtij parku në tri vitet e fundit ka filluar t'u shkaktojë problemet e para banorëve të fshatit Koreticë e Epërme të cilët gjenden afërsisht 2 kilometra larg nga ky park.

Lumi "Kroi i Mbretit" që kalonte përreth shtëpive të banorëve nga i cili ata furnizoheshin me ujë të përdorshëm, filloi të ndotej nga ujërat e zeza të cilat derdhen në lum. Kjo për faktin se gypat e rrjetit të kanalizimit nuk ishin vendosur në tërësi deri te rrjeti kryesor. Në kohërat e mëhershme banorët e këtij fshati ishin furnizuar me ujë nga pusët e hapura në mungesë të rrjetit të ujësjellësit, por që ato puse tashmë janë të papërdorshme për shkak të ujit të kontaminuar.

Në dhjetor të vitit 2015, MTI kishte kërkuar të testohet uji nga burimi natyral, dhe nga analizat që i kishte bërë Kompania e Ujësjellësit Rajonal Prishtina. Sipas mostrave të ekzaminuara dhe bazuar në Standardet për ujëra sipërfaqësore, ishte konstatuar se kimikisht këta ujëra janë ujëra jo të pijshëm, pra të kategorisë II që mund të shfrytëzoheshin vetëm për nevoja teknike si ujitje, larje të rrugëve, etj³⁰.

Sipas banorëve përveç ujërave të zeza që derdhen në lum, aty derdhen edhe mbetjet industriale nga prodhimet e produkteve të bizneseve si plastika dhe mbeturina të tjera me përmbajtje kimike.

Që nga fillimi i ndërtimit të këtij parku vetëm për ndërtimin, trajtimin dhe mirëmbajtjen e impiantit për ujëra të zeza janë lidhur katër kontrata përgjatë periudhës 6 vjeçare por ende nuk është bërë sanimi i të gjitha problemeve.

Kontrata e parë për ndërtimin e impiantit për pastrimin e ujërave të zeza është kontraktuar në tetor të vitit 2009³¹ në vlerë prej 902,779.70 €, e cila është shkëputur për arsye të kontesteve pronësore që ka qenë përgjegjësi e komunës së Drenasit³²

Para se të fillojë implementimi i kontratës MTI i ka paguar kompanisë 90,277.98 € në emër të avancit apo 10% të shumës së kontratës për fillimin e punëve.

30 Dokument Nr.3429 nga laboratorit i KUR Prishtina, departamenti i kualiteti të ujit, data 08.12.2015

31 Njoftim për dhënie të kontratës, MTI204-09-096-5-1-1, data 16.10.2009 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtIID=ViewNotices&ID=24283>

32 Memorandum bashkëpunimi mes MTI-së dhe Komunës së Drenasit, data 21.07.2005



Kompania ka filluar punimet në terren në maj të vitit 2010 dhe deri në shkëputje të kontratës sipas raportit përfundimtar nga menaxheri i projektit kjo kompani ka shpenzuar 23,792.81 € përderisa pjesa e mbetur e avancit prej 66,485.17 € është dashur t'i kthehet MTI-së nga ana e kompanisë.

Kompania në fjalë nuk është pajtuar t'i kthejë mjetet e mbetura për arsye të dëmeve që i janë shkaktuar me fajin e MTI-së. Duke mos i mundur kjo, ajo ka parashtruar edhe padi kundër MTI-së duke deklaruar se në total ka investuar 99.950.00 €, e jo vlerën të cilën e ka përllogaritur MTI sipas raportit përfundimtar.

Nga ana tjetër, MTI ka kërkuar nga banka që shuma në vlerë prej 135,417.00 €, sa ka qenë garancioni bankar për sigurimin e punëve, t'i konfiskohet kompanisë, por banka nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë.

MTI ka bërë ankesë edhe në Bankën Qendrore të Kosovës për bankën komerciale e cila nuk iu është përgjigjur kërkesës për ekzekutimin e garancisë së avancit, por e njëjta është përgjigjur se “nuk mund të lëshohet në shqyrtimin e rasteve, për të cilat zhvillohen apo janë zhvilluar procedura gjyqësore”³³

Për shkak të gjitha problemeve me planifikim dhe menaxhim të këtij investimi, arnimet e punëve i kanë kushtuar buxhetit të Kosovës 66,485.17 €, të cilat ishin paguar si avanc për punët që nuk ishin realizuar!

Kontrata e dytë për ndërtimin e kanalizimit të impiantit për pastrimin e ujërave të zeza u kontraktua në qershor të vitit 2010 në vlerë prej 284,814.94 €³⁴, edhe pse problemi i kontestit pronësor nuk ishte zgjidhur dhe MTI ishte në

dijeni se mund të ballafaqohet me problemet e njëjta ata ishin të detyruar të bënin një zgjidhje emergjente për ta rregulluar përkohësisht problemin e rrjetit të kanalizimit dhe ndërtimin e një impianti për trajtimin e ujërave të zeza³⁵.

Edhe pse projekti ka filluar para 7 viteve, ai ende nuk ka përfunduar! Janë kryer vetëm 80% të punëve të cilat janë paguar në vlerë prej 233,475.77 €, pjesa tjetër e kontratës është pezulluar përkohësisht për shkak problemit të vjetër të kontestit pronësorë.

Menaxheri i projektit të kësaj kontrate, ka shpjeguar për KDI-në se sipas kontratës gjatësia e rrjetit të kanalizimit për Parkun e Biznesit në Drenas kap një sipërfaqe prej 3.500 m². Sipas projektit një pjesë e tubave të kanalizimit duhej të kalonin nëpër një prone private, por që pronari i pronës nuk e kishte lejuar një gjë të tillë.

Në bazë të standardeve, rrjeti i kanalizimit duhej të ndërtohej nga pjesa poshtme duke u ngjitur lartë deri te Parku i Biznesit në Drenas, por për shkak problemeve ata ishin detyruar që të fillojnë ndërtimin nga lartë deri te prona private dhe aty ka pasur shkëputje.

Si rrjedhojë ujërat e zeza kanë filluar të derdhen në lum. Sipas menaxherit të projektit, punë të përfunduara dhe vendosje të tubave janë afërisht 2.500 m².³⁶ Për shkak se çështja pronësore ende vazhdon të mbetet e pazgjidhur, kjo kontratë ka mbetur e pezulluar.

Kontrata e tretë për finalizimin e punëve për “Ndërtimin e Impiantit për pastrimin e ujërave të zeza në Parkun e Biznesit” e kontraktuar në korrik të vitit 2014 në vlerë prej 264,294.97 €³⁷, dhe për punë shtesë në vlerë prej 23,817.54 €³⁸ ka përfunduar.

33 Përgjigje në ankesën e dërguar nga MTI nga BQK, data 10 mars 2016

34 Njoftim për dhënie të kontratës, MTI204-10-055-5-2-1, data 17.06.2010 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtIID=ViewNotices&ID=32114>

35 Intervistë me Menaxherin e Prokurimit nga MTI, Prishtinë, data 20.09.2017

36 Intervistë me Menaxherin e Projektit të kontratës me nr.të prok. MTI204/10/055/521, Prishtinë, data 20.09.201

37 Njoftim për dhënie të kontratës, MTI204-09-088-5-1-1, data 15.07.2014 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtIID=ViewNotices&ID=22929>



Ndotje tjetër e ambientit sipas banorëve të asaj zone, është derdhja e vazhdueshme e ujërave të zeza nëpër fusha nga kompania përgjegjëse për mirëmbajtjen e Parkut të Biznesit në Drenas.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në shkurt të vitit 2016 ka kontraktuar një kompani private për mirëmbajtjen e Parkut të Biznesit në Drenas në vlerë prej 12.990.00 €³⁹

e cila ka qenë përgjegjëse për pastrimin e mbetjeve në impiantin për trajtimin e ujërave të zeza dhe industriale, si dhe largimin e mbeturinave dhe mbetjeve tjera nga impianti deri te deponitë legale, e kjo kompani këto mbeturina i ka derdh nëpër livadhet e fshatit.

Për shkak të dëmit të shkaktuar nga ujërat e zeza të PBD, banorët e fshatit Koreticë e Epërme udhëtojnë çdo ditë nga 8 kilometra për furnizim me ujë për pije, gatim apo higjenë personale!

Inspektorati i mjedisit dhe ambientit të komunës së Drenasit në shkurt të vitit 2017 ka inspektuar punën e kompanisë dhe është vërtetuar se kompania përgjegjëse për pastrimin e Parkut të Biznesit në Drenas ka grumbulluar mbeturinat nga PBD dhe i ka shkarkuar në puseta, të cilat nëpërmjet nënkallimit kanë kaluar në përroskë dhe kanë ndotur ujin e ambientit.⁴⁰

Inspektime ka kryer edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në mars të vitit 2017, me ç'rast ka gjobitur kompaninë me 100.00 €, po ashtu gjobë për atë kompani ka shqiptuar

edhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në vlerë prej 70.00 €. MTI po ashtu ka potencuar se kësaj kompanie i ka skaduar kontrata e pastrimit, tani PBD e pastron një kompani tjetër e cila vazhdimisht monitorohet nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

Kompania e gjobitur ka ofertuar sërish për të marrë tenderin për pastrimin e Parkut të Biznesit në Drenas, por Ministria e Tregtisë dhe Industrisë nuk e ka 'shpërblyer' me kontratë për shkak shkeljes së kushteve kontraktuale të kontratës së kaluar pavarësisht se ka ofertuar me çmimin më të lirë.

Në fshatin Koreticë e Epërme, 2 km afër Parkut të Biznesit Drenas, jetojnë 15 familje. Secila nga këto familje është dëmtuar materialisht nga ndërtimi i parkut të biznesit, duke ua vështirësuar jetesën dhe duke u krijuar shpenzime shtesë në buxhetin familjar për produkte apo furnizime esenciale⁴¹.

Për shkak të ndotjes së ujit, pesëmbëdhjetë familjet e fshatit Koreticë e Epërme, që 3 vite radhazi detyrohen të furnizohen me ujë për nevoja të pijes, gatimit dhe higjienës, në burime të ndryshme. Një nga burimet kryesore është mbushja e ujit tek burimi natyror, i cili ndodhet rreth 4 kilometra larg fshatit. Këto familje rrugëtojnë rreth 8 kilometra në ditë për të siguruar këtë furnizim. Nëse marrim një mesatare të shpenzimeve prej 6 litra në 100 kilometra, dhe një çmim mesatar prej 1€ për derivate (naftë/benzinë) i bie që në ditë këto familje shpenzojnë rreth 0.48€, dhe 175 € në vit për t'u furnizuar me ujë. Për tri vite radhazi, buxheti familjar është rënduar prej rreth 525.6 € vetëm për derivate.

38 Njoftim për dhënie të kontratës, MTI204-15-008-5-2-5, data 08.07.2015 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=102467>

39 Njoftim për dhënie të kontratës, MTI204-16-061-2-2-1, data 29.02.2016 <https://krpp.rks-gov.net/Default.aspx?PID=Notices&LID=1&PCID=-1&CtlID=ViewNotices&ID=113481>

40 Raport Nr.13017 për shkarkimin e ujrave të zeza jasht impiantit, nga Drejtoria e Inspeksionit, komuan e Drenasit, data 10.03.2017

41 Hulumtime nga terreni, intervista me banorët e fshatit Koreticë e Epërme, Drenas, data 17.08.2017

Përmes linjës pa pagesë 0800 77777 në KDI ka raportuar një bletar nga ky fshat, i cili kishte kultivuar mjaltë për shitje, e nga ambienti i papastër para 2 viteve bletët i kanë vdekur. Ai i ka humbur 10 koshere me bletë, ku një koshere me bletë kushton afërsisht 100 €, e në total këto bletë kishin një çmim prej 1,000.00 €. Nga këto bletë banori çdo vit kishte kultivuar nga 100 kg mjaltë, të cilat i kishte shitur nga 10.00 € për kilogram. Të hyrat familjare të kësaj familje, me rastin e vdekjes së bletëve, janë zvogëluar prej rreth 1,000.00 € të ardhura në vit, e që do të thotë se për dy vite, kjo familje ka humbur të ardhura prej rreth 2,000.00 €

RASTE TË TJERA TË HUMBJES TË PARASË PUBLIKE NGA MENAXHIMI I DOBËT I KONTRATAVE

Raste të evidentuara të menaxhimit të dobët të kontratave dhe performancës së dobët të Operatorëve Ekonomik janë identifikuar edhe gjatë grupit të fokusit të organizuar nga KDI⁴², me qëllim të trajtimit të këtij problemi.

3.1. Palestra e Sporteve Shtime

Një nga rastet e identifikuar gjatë këtij grupi të fokusit, është edhe rasti i palestrës së sporteve në Komunën e Shtimës. Mosmarrëveshjet në mes Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik për ndërtimin e palestrës së sporteve në komunën e Shtimes, ka lënë projektin e pa përfunduar për gati 5 vite. Ky projekt kishte filluar në vitin 2010 i financuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, dhe vlera e tij ishte 1,864,699.70 €. Sipas Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Komunës së Shtimes, objekti ka mbetur i papërfunduar për arsye se kompania ndërtuese e

Sipas Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit Komuna e Shtimes, kontrata e re për riparim dhe funksionalizim të palestrës ka një vlerë prej 400,000.00 €, e cila përveç përfundimit të punëve të pakryera, parasheh edhe rregullimin e dëmeve të shkaktuara

ka akuzuar Ministrinë përkatëse për mos pagesën e mjeteve për punë shtesë. Komuna e Shtimes vazhdimisht ka bërë përpjekje që ky objekt të funksionalizohet por nuk ka gjetur përkrahjen nga MKRS. Në fillim të vitit 2017, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit më në fund është pajtuar të përfundojnë objektin dhe të funksionalizoj palestrën përmes dhënies së një kontrate të re, për të cilën kontratë procedurat e prokurimit i ka udhëhequr vetë komuna, ndërsa financimi është bërë nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Në mungesë të sigurimit, popullimit apo mbikëqyrjes së objektit, punimet e kryera paraprakisht ishin dëmtuar në masë, sidomos meqë ishte vjedhur material ndërtimorë, si dhe ishin demoluar disa pjesë të objektit, të cilat duhet të riparohen në mënyrë që të funksionalizohet ky objekt. Gjatë vizitës së palestrës, është vërejtur punëkryesi duke e rregulluar ambientin e jashtëm me kubëza betoni, disa nga dritaret kanë qenë të thyera, brenda objektit është vërejtur demolimi i dyshemesë, si dhe mungonin të gjitha kabllot elektrike, dhe gypat e ujit, ku sipas sigurimit, tashmë i kontraktuar nga komuna e Shtimes, ato kishin ekzistuar por ishin vjedhur.

42 Grupi i fokusit i mbajtur me 18.08.2017, në zyrat e KDI

Edhe në këtë rast vërejmë se si rezultat i menaxhimit të dobët të kontratës publike, për paqartësi rreth aneks kontratës për punët shtesë, e cila nëse do të ishte kontraktuar me kohë do t'i kushtonte buxhetit 186,470 € apo 10% i vlerës së kontratës, qytetarët e Kosovës do të paguanj 400,000 € shtesë për këtë projekt. Përveç implikimeve financiare, mungesa e palestrës ka vështirësuar mbarëvajtjen e aktiviteteve sportive në këtë komunë. Klubet e hendbollit të femrave "Vjosa", që nga riaktivizimi i këtij ekipi, stërvitjet po zhvillojnë në shkollat të cilat posedojnë salla sportive dhe në ambiente të hapura. Sportistet e këtij klubi ndonjëherë udhëtojnë deri te palestra e sporteve në Ferizaj. Klubi futbollistik i Shtimes po ashtu zhvillon stërvitjet në ambiente të hapura, ndërsa në mungesë të palestrës kjo komunë asnjëherë nuk ka mundur ta aktivizojë klubin e basketbollit për arsye se për këtë sport nevojitet salla me tavane të larta⁴³.

3.2. Pllatoja mbi Kurriz

Një projekt tjetër që ka bërë bujë me mungesën e menaxhimit të mirëfilltë të kontratës është "Ndërtimi i bulevardit mbi kurriz", i cili ishte kontraktuar në vitin 2015 dhe ende nuk ka përfunduar në tërësi. Kohëzgjatja e kësaj kontrate ishte 180 ditë, por për shkak se projekti ishte hartuar gabimisht punët nuk kishin përfunduar me kohë.

Në qershor të vitit 2017, agjencia e lajmeve Lajmi.net kishte raportuar mbi gjendjen e punimeve mbi pllantonë e Kurrizit, duke evidentuar

se disa pllaka të vendosura mbi pllantonë ishin të prera me fleks, disa nga to ishin vendosur të plasaritura ose të qara, dhe cilësinë e dobët të tyre e kishte dëshmuar edhe gjendja e dhjetëra pllakave të thyera që kishin qëndruar nëpër qoshe. Në ndërkohë sipas gjendjes në teren Lajmi.net kishte konstatuar se pllatoja nuk pritej të përfundonte edhe për disa javë, pasi në dy hyrjet nga Posta dhe nga Rruga "Bill Klinton" ende nuk kishin filluar punimet."⁴⁴

Edhe Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA), për dy vite radhazi, në raportet e rregullsisë për Komunën e Prishtinës kishte raportuar shqetësime lidhur me këtë projekt. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2015, për komunën e Prishtinës, potencon se për projektin e "Ndërtimit të bulevardit mbi kurriz" në vlerë prej 977,726 €, komuna kishte lidhur kontratë ku ishte përfshirë edhe pozicioni për hartimin e projektit pas ekzekutimit. Në këtë mënyrë ishte bërë kontraktim i dyfishtë për të njëjtin shërbim, pasi që komuna kishte bërë hartimin e këtyre projekteve para fillimit të procedurës së ekzekutimit⁴⁵. Në raportin e Auditimit për pasqyrat financiare të vitit 2016 për komunën e Prishtinës, ZKA përsëri kishte raportuar shqetësime për projektin e njëjtë, por kësaj radhe auditori potencon se komuna nuk ka pasur mjete të ndara për projektin në fjalë por ato i ka siguruar nga një projekt tjetër infrastrukturorë e sipas auditorit një gjendje e tillë do të zvogëlonte zbatimin efektiv të planeve të parapara të shpenzimeve kapitale, dhe pasqyrim të pasaktë të projekteve të realizuara brenda kategorisë së investimeve kapitale"⁴⁶

43 Intervistë me Drejtorinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Komuna Shtime, 21.08.2017

44 Platoja mbi 'Kurriz' po shtrohet me pllaka që Shpendi i bleu të kandidati i VV-së për deputet (Dokument), Prishtinë, publikuar në portalin www.lajmi.net më 02.06.2017

<http://lajmi.net/platoja-mbi-kurriz-po-shtrohet-me-pllaka-qe-shpendi-i-bleu-te-kandidati-i-vv-se-per-deputet-dokument/>

45 Raporti i Auditimit Nr.20.0.1-2015-08, për pasqyrat financiare të komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetorë 2015 nga ZKA, Prishtinë qershorë 2016

<http://www.zka-rks.org/wp-content/uploads/2017/06/RaportiAuditimit.KPR.2015.Shqip.763234.pdf>

46 Raporti i Auditimit Nr.22.0.1-2016-08, për pasqyrat financiare të komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar më 31 dhjetorë 2016 nga ZKA, Prishtinë qershorë 2017

file:///C:/Users/Admin/Downloads/Prishtina_KPR.2016.Shqip.50520.pdf

Media të ndryshme kishin raportuar përgjatë periudhës 2016-2017, se për shkak të punëve të pa kryera dhe punimeve të dobëta, banorët ankohen se sa herë ka të reshura, ata përballen me probleme të rrjedhjes së ujit në lokalet dhe korridoret e qendrës tregëtare nën kurriz^{47 48 49}. Problemi me këtë projekt ishte identifikuar edhe në raportin e OJQ GAP, të publikuar në 2017, e që analizon problemet aktuale të komunës së Prishtinës. Edhe në këtë raport është cekur se vonesat në realizimin e këtij projekti kishin paraqitur rrezik për banorët, sidomos fëmijët, e këtij kompleksi, si dhe ankesa të shumta nga bizneset që operojnë në këtë kompleks për humbje financiare si rezultat i dëmtimeve që u bëhen lokaleve të tyre nga depërtimi i shiut dhe të reshurave përtej platosë⁵⁰. KDI kishte biseduar me afarist që veprojnë në zonë të cilët kishin thënë se nga problemet me realizimin e këtij projekti, deri më tani kanë mbyllur veprimtarinë 8 ndërmarrës⁵¹.

3.3. Raportime të ndryshme të problemeve me të cilat ballafaqohen qytetarët nga ndërtimi i dobët i rrugëve

Problemi me cilësinë e punëve të kryera në rrugët e Kosovës ngjanë si një epidemi e përmasave alarmante. Është një problem me të cilin ballafaqohen qytetarët rreth e rrotull vendit, dhe ku humbet më së shumti paraja e tatimpaguesit duke paguar disa herë për të njëjtën punë. Mungesa në kualitetin e punës do të bëjë që qytetarët të paguajnë përsëri për një punë e cila do të duhet të kishte garanci disa vjeçare e jo disa muajsh.

Agjencia lokale e lajmeve Veriu.info në korrik 2017 kishte raportuar një situatë të mjerueshme të rrugëve në Skenderaj, të cilat shumë shpejt pas asfaltimit kishin filluar të prishen si pasojë e mungesës së cilësisë dhe mos përm-bushjen e standardevë të kërkuara. Sipas po të njëjtit burim, kjo kishte ndodhur për faj të Autoritetit Kontraktues, të cilët kishin kontraktuar kompani për të cilat e kishin ditur që nuk kanë kapacitete apo kanë historik të punimeve të dobëta⁵².

Theranda Post, një tjetër agjenci lokale e lajmeve, në shkurt të 2017, raporton për një gjendje tejet të rëndë të rrugëve të qytetit të Therandës (Suharekës). Në vazhdim, Theranda post kishte kontaktuar Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë sipas të cilëve problemet ishin si rrjedhojë e punimeve nga një kompani private të cilët duhet ta kthejnë në gjendje të mëparshme⁵³. Megjithatë, në maj 2017, po e njëjta agjenci e lajmeve kishte publikuar një artikull të dytë, ku pasqyrohej dhe reagohej ndaj gjendjes shumë të keqe të rrugëve në Suharekë, ku shihen gropa, shembje e plasaritje të rrugëve, trotuareve dhe kanaleve të shiut, si pasojë e punëve jo cilësore⁵⁴.

Rruga "Muharrem Fejza" në Prishtinë, ishte riparuar në vitin 2012, dhe përsëri në nëntor të vitit 2016, pas përfundimit të vendosjes së kablove të rrjetit elektrik nën tokë, megjithatë, në maj të vitit 2017, sipas një raportimi nga Lajmi.net, ishte në gjendje të mjerueshme. Trafiku i stër-ngarkuar dhe kualiteti i dobët i punëve kishin bërë që asfalti të shpërbëhej dhe rruga e trotuaret të shembeshin⁵⁵.

47 Klan Kosova: Kjo është gjendja pas shiut në Prishtinë, 2 shtator 2016: <http://klankosova.tv/kjo-eshte-gjendja-pas-shiut-ne-prishtine-video/>

48 Gazeta Express: Zvarritje dhe punime jociësore në "Kurriz", thyhen kubëzat e qelqit, 5 shtator 2017: <http://www.gazetaexpress.com/lajme/zvarritje-dhe-punime-jocilesore-ne-kurriz-thyhen-kubezat-e-qelqit-429595/>

49 Infokusi: Ankohen qytetarët e lagjës "Dardania" për vonesën e punimeve mbi 'kurriz' 11 tetor 2016: <http://infokusi.com/old/ankohen-qytetarët-e-lagjës-dardania-per-vonesën-e-punimeve-mbi-kurriz-video/>

50 Instituti GAP: Komuna e Prishtinës 2017: Problemet kryesore dhe trendet buxhetore, 2017, fq.2

51 Intervista me ndërmarrës që veprojnë në Kurriz (identiteti I njohur për KDI), 18 tetor 2017.

52 Veriu.info: Shumica e rrugëve të asfaltuara në Skenderaj u dëmtuan për shkak ndërtimit të dobët, 16 korrik 2017, <http://www.veriu.info/shumica-e-rrugeve-te-asfaltuara-ne-skenderaj-u-demtuan-per-shkak-ndertimit-te-dobët/>

53 Theranda Post: Kanal e gropa midis qytetit të Suharekës 14 shkurt 2017

54 Theranda Post: Po gropat, kur do të rregullohen? 08 maj 2017

55 Rruga 6 muajsh: Ky është standardi i të shtruarit asfalt i Shpend Ahmetit (Foto), Prishtinë e publikuar në portalin www.lajmi.net, data 03.05.2017

KTV kishte bërë një reportazh me titullin Gropat në rrugë, ku tregohet gjendja e vështirë e shumë rrugëve në kryeqytet. Edhe pse komuna ka një kontratë kornizë një vjeçare për sanimin e rrugëve, gjendja e rrugëve është ende e rëndë⁵⁶.

Gazeta Express, me 4 Korrik 2017, kishte raportuar se asfalti i shtruar vetëm dy ditë më parë "Rrugën e Flamurit" afër shkollës fillore "Lekë Dukagjini" kishte filluar të shpërbëhej nga kualiteti i dobët⁵⁷.

Portali Kallxo.com, pjesë e rrjetit të BIRN, raporton për prishjen e asfaltit në magjistralen Gjakovë-Pejë, brenda 24 orëve pas shtrimit⁵⁸. Po të njëjtit, raportojnë për një situatë të rëndë edhe në rrugën që shpie në Grykën e Rugovës, ku gropat ishin krijuar në riparimet/pjesët e sanuara të kësaj rruge⁵⁹.

Një gjendje e njëjtë raportohet edhe me rrugët e Gjilanit, ku si pasojë e punimeve të dobëta, pak muaj pas asfaltimit, një rrugë në lagjen "Gavran" veçse ka filluar të priset e mbushet me gropa⁶⁰. Sipas Portalit "Gjilani Ynë" rruga

Gjilan-Bujanoc, që kishte kushtuar 900,000 EURO, pak muaj pas riparimit, veçse ishte dëmtuar dhe gropat ishin shfaqur gjithandej⁶¹.

Të gjitha këto probleme shkaktojnë vështirësi në jetesën dhe aktivitetet e qytetarëve duke ju rritur edhe shpenzimet e buxhetit familjar si rritja e shpenzimeve të derivateve, amortizimi i automjeteve, rreziku ndaj aksidenteve në mes udhëtarëve, rreziku nga aksidentet për këmbësorët, etj. Ajo që është shqetësuese është se qytetarët paguajnë, ri paguajnë dhe stër-paguajnë për shërbime të cilat nuk i marrin, apo i marrin të një kualiteti dytësor apo tretësor, si mungesë e menaxhimit të mirëfilltë të kontratave, e veçmas si mungesë e llogaridhënies institucionale dhe afariste/implementuese!

Edhe pse, raportimet për problemet lidhur me menaxhimin e kontratave vazhdojnë të jenë temë e përditshme, sidomos tek investimet kapitale, ku kostoja që bartë buxheti publik për riparime si dhe kostoja që rëndon buxhetet familjare janë shumë të mëdha, ky problem ende ka mbetur i pa adresuar dhe i pazgjidhur nga institucionet tona.

56 First Channel TV: Rrugët e Prishtinës gropa-gropa, 6 qershor 2017, <http://www.first-channel.tv/2017/06/06/rruget-e-prishtines-gropa-gropa-video/>

57 Gazeta Express: Ndodh edhe kjo: Rruga e asfaltuar para dy dite, priset në Prizren, 4 korrik 2017, <http://www.gazetaexpress.com/lajme/ndodh-edhe-kjo-rruga-e-asfaltuar-para-dy-dite-priset-ne-prizren-video-399017/>

58 Kallxo.com: Priset Asfalti pa i Mbushur 24 Orë, 26 maj 2017, <http://kallxo.com/priset-asfalti-pa-mbushur-24-ore/>

59 Kallxo.com: 'Arnimi I Shqyer' I Rrugës drejt Rugovës, 30 maj 2017, <http://kallxo.com/arnimi-shqyer-rruges-drejt-rugoves/>

60 Indeksonline: Priset asfalti në Gjilan, pak kohë pasi u shtrua, 27 korrik 2017, <http://indeksonline.net/lajmet/priset-asfalti-ne-gjilan-pak-kohe-pasi-u-shtrua-foto-113030/>

61 Portali Gjilani Ynë, 31 maj 2013: <https://www.facebook.com/gjilaniyne/posts/509039489219864:0>

DISPOZITAT LIGJORE

Ligji për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Neni 81, përcakton dispozitat për aktivitetet e menaxhimit të kontratës. Sipas ligjit në fjalë autoritetet kontraktuese duhet që si pjesë e përgatitjes së aktivitetit të prokurimit të prodhojnë një plan të menaxhimit të kontratës dhe përcakton procedurat. Sipas po këtij neni, përveç përcaktimit të menaxherit të kontratës, varësisht nga rrethana, plani për menaxhimin e kontratës duhet të përfshijë edhe "(i) ekipet e menaxhimit të projekteve; (ii) rishikime të shpeshta të kontratës; (iii) protokollet për dorëzimin e pajisjeve të autorizuara; (iv) dialogun e rregullt me kontraktuesit; (v) përdorimin e standardeve korrekte të cilësisë; (vi) menaxhimin të pagesave / kërkesave; (vii) procedurat e ankesave; (viii) mjetet e kontrollit të specifikuar në kontratë, dhe (ix) sigurimi i ekzekutimit mbahet për defekte / korigjim". Gjithashtu, sipas paragrafit 3 të po të njëjtit nen, "plani i menaxhimit të kontratave duhet të paktën të përfshijë: (i) emrin e zyrtarit/zyrtarëve të autoritetit kontraktues përgjegjës për menaxhimin e kontratës, dhe ku është e aplikueshme, rezidentin e kualifikuar për mbikëqyrje apo inxhinierin / inxhinierët e projektit; (ii) numri dhe kategoritë e personelit ndihmës në dispozicion të zyrtarit për

qëllime të menaxhimit të kontratave, duke përfshirë ekspertë teknik të jashtëm të rekrutuar; (iii) një afat kohor ose një plan projekt gantogram (ganat charts), diagrame për aktivitetet e menaxhimit të kontratave që përfshijnë kohëzgjatjen e kontratës. KRPP-ja monitoron menaxhimin e kontratës."

Në vazhdim, sipas legjislacionit dytësor, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, neni 61 adreson procedurat për menaxhimin e kontratës.

Paragrafi 61.17 Një kontratë me vlerë të madhe që është komplekse ose është pjesë e një projekti më të madh, mund t'i jepet një Ekipi për Menaxhimin e projektit, i cili do të ketë përgjegjësitë e njëjta sikurse Menaxheri i Projektit. Në vijim, pika 61.20 definojnë edhe përgjegjësitë e menaxherit të projektit, ku ndër të tjera kërkohet që Menaxheri i Kontratës: a) Të sigurojë që operatori ekonomik i përbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës; c) të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës; k) t'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA.

56 First Channel TV: Rrugët e Prishtinës gropa-gropa, 6 qershor 2017, <http://www.first-channel.tv/2017/06/06/rruget-e-prishtines-gropa-gropa-video/>

57 Gazeta Express: Ndodh edhe kjo: Rruga e asfaltuar para dy dite, prishet në Prizren, 4 korrik 2017, <http://www.gazetaexpress.com/lajme/ndodh-edhe-kjo-rruga-e-asfaltuar-para-dy-dite-prisnet-ne-prizren-video-399017/>

58 Kallxo.com: Prishtet Asfalti pa i Mbushur 24 Orë, 26 maj 2017, <http://kallxo.com/prisnet-asfalti-pa-mbushur-24-ore/>

59 Kallxo.com: 'Arnimi I Shqyer' I Rrugës drejt Rugovës, 30 maj 2017, <http://kallxo.com/arnimi-shqyer-rruges-drejt-rugoves/>

60 Indeksonline: Prishtet asfalti në Gjilan, pak kohë pasi u shtrua, 27 korrik 2017, <http://indeksonline.net/lajmet/prisnet-asfalti-ne-gjilan-pak-kohe-pasi-u-shtrua-foto-113030/>

61 Portali Gjilani Ynë, 31 maj 2013: <https://www.facebook.com/gjilaniyne/posts/509039489219864:0>

Gjatë analizimit të investimeve të sipër cekura, si dhe hulumtimeve paraprake të KDI në fushën e prokurimit publik, kemi vërejtur se në të shumtën e rasteve është përcaktuar vetëm një menaxher i kontratës, madje edhe për investime kapitale komplekse, dhe nuk është shfrytëzuar mundësia e krijimit të ekipeve për menaxhimin e kontratave. Gjithashtu, duke u bazuar edhe në raportet e rregullsisë të Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin 2016⁶², problemet më të mëdha në sistemin e prokurimit kur kemi parasysh se edhe realizimi i pagesave bie nën menaxhimin e kontratave. Por, ajo që mbetet më shqetësuesja është neglizhimi i kualitetit të punës, e cila jo vetëm që rrit koston e mirëmbajtjes, por sidomos tek investimet kapitale, edhe në rrezikon jetën e qytetarëve.

Sipas Institutit të Licensuar për Prokurim dhe Furnizime (Chartered Institute of Procurement and Supply-CISP), menaxhimi i kontratës është një proces i vazhdueshëm i prokurimit që siguron furnizuesit dhe blerësit që t'i përmbahen detyrimeve kontraktuale të dakorduara, së bashku me negocimin e çdo ndryshimi të ardhshëm që duhet të bëhet⁶³.

Sipas po të njëjtit Institut, Monitorimi i performancës së furnitorëve është një aspekt kyç i Prokurimit dhe Menaxhimit të Furnizimit, por që lehtë mund të jetë i nënvlerësuar, me mungesë të resurseve të nevojshme dhe i lënë pas dore⁶⁴. Kur monitorimi i performancës bëhet pas dhënies së kontratës, qëllimi është i dyfishtë:

a) të sigurojë që furnizuesi është duke përbushur kriteret e performancës, p.sh. nivelet dhe cilësinë e shërbimit, kushtet e përcaktuara në kontratë, dhe

b) të identifikojë mundësitë për përmirësim.

Sipas një hulumtimi të zhvilluar nga Asociacioni Ndërkombëtar për Menaxhim Komercial dhe të Kontratave, menaxhimi i mirë i kontratave do të përkthehej në rreth 9% kursime për institucionet, dhe rreth 9% të hyra për kompanitë. Për kompaninë shihet si e hyrë sepse në rast se performon mirë, atëherë ka potencial të fitojë tenderë të tjerë në bazë të referencave për punët e kryera.

Dispozitat aktuale ligjore në Kosovë nuk adresojnë këtë komponentë kyç, të monitorimit të performancës, në aktivitetet e menaxhimit të kontratave. Në mungesë të rregullave për rregullimin dhe zbatimin e kësaj komponentë, Operatorët Ekonomik, në neglizhencë të menaxhimit të kontratës, vazhdojnë të punojnë në standarde të ulëta dhe pa cilësi, dhe për kundër të gjitha akuzave nga publiku ndaj institucioneve, këta operatorë ekonomik vazhdojnë të punojnë të paprekur dhe të pasurohen nga paraja e qytetarit në kurriz të qytetarit. Në anën tjetër, për furnitorë serioz, menaxhimi i dobët i kontratës do të jetë shumë frustrues, dhe do t'i bëjë të humbin besimin në institucione, dhe të tërhiqen nga tregu i prokurimit publik. Kjo do të rezultonte në uljen e konkurrencës dhe krijimin e hapsirës për operatorë Ekonomik të pandërgjegjshëm.

62 Zyra Kombëtare e Auditimit, Raportet e Auditimit të Rregullsisë, 2016: <http://www.zka-rks.org/publications/>

63 Chartered Institute of Procurement & Supply: <https://www.cips.org/en/knowledge/contract-management-cycle/>

64 Chartered Institute of Procurement & Supply: Monitoring the Performance of Suppliers, fq. 1, CIPS 2013

KONKLUZIONE

Prokurimi publik i referohet procesit nëpërmjet të cilit autoritetet publike, siç janë departamentet qeveritare ose autoritetet lokale, blejnë mallra ose shërbime nga kompanitë⁶⁵. Transparenca, integriteti, ekonomiciteti, korrektesia, konkurrenca dhe llogaridhënia janë disa nga parimet themelore të prokurimit publik⁶⁶. Ajo që konkludojmë nga ky hulumtim është se në përgjithësi, nga rastet e trajtuara më sipër, parimet bazë të prokurimit publik nuk respektohen as nga Autoritetet Kontraktuese, e as nga Operatorët Ekonomik. Edhe pse, gjatë këtij hulumtimi, shumica e Institucioneve ishin të gatshme për bashkëpunim, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë nuk kishte ofruar qasje në dokumentet publike të kërkuara konform Ligjit për qasje në dokumente publike. Në përgjithësi, nga ky hulumtim mund të konkludojmë se përballemi me dy çështje të natyrave të ndryshme.

Çështja 1:

Mungesat në ligj për menaxhimin e mirëfilltë të kontratave, kanë lejuar një punë të dobët dhe rritje të investimeve për të "arnuar" punët e kryera paraprakisht.

Në rastin e Shkollës "Tefik Çanga" tatimpaguesi, Përmes Drejtorisë për Arsim në Ferizaj, ka paguar 55,220.00 € shtesë për të riparuar punën e cila veçse ishte paguar një herë nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë.

Tek rasti i Parkut të Biznesit në Drenas, planifikimi dhe menaxhimi i dobët i kontratës, i ka kushtuar tatimpaguesit/buxhetit të Kosovës 66,485.17€. Në rastin e Palestrës Sportive në Shtime, si rezultat i menaxhimit të dobët të kontratës publike, qytetarët e Kosovës do të paguanë 400,000 € shtesë për riparimin e dëmeve të shkaktuara në mungesë të përkujdesjes dhe për përfundimin dhe funksionalizimin e këtij objekti. Përderisa në rastin e Parkut të Biznesit, Autoriteti Kontraktues ka marrë disa masa llogaridhënese duke shkëputur kontratën me njërin nga Operatorët e papërgjegjshëm, megjithatë në asnjërin nga rastet e trajtuara nuk ka pasur penalizime.

Me qëllim të rritjes së integritetit dhe performancës së institucioneve, si dhe vetëdijesimit të Operatorëve Ekonomik për përgjegjësitë e tyre, është mëse e nevojshme që legjislacioni aktual të modifikohet, për të adaptuar modele të suksesshme për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të performancës së kontratës. Një politikë e tillë do të rezultonte edhe në krijimin e një sistemi vlerësues të Operatorëve Ekonomik, ku ata të përgjegjshmit do të shpërbleheshin për dedikimin e tyre, ndërsa ata të papërgjegjshmit do të ndëshkoheshin, e që do të ndikonte edhe në edukimin e operatorëve ekonomik për një sinqeritet afarist, dhe do të ndikonte në zvogëlimin e mundësive të përfitimeve nga neglizhimi i kualitetit të kontratës.

65 Komisioni Evropian: Prokurimi Publik: https://ec.europa.eu/growth/single-market/public-procurement_en

66 Jorge Lynch, Prokurimi Publik: Parimet, kategoritë dhe metodat, Kapitulli 2: Parimet themelore të prokurimit public, 2013

Çështja 2:

Nga shqyrtimi i rasteve në fjalë, KDI konstaton se mungon edukimi i qytetarëve për ushtrimin e të drejtës për kërkesë të kompensimit të dëmeve personale dhe familjare të shkaktuara nga rezultatet e shërbimeve apo investimeve publike. Tek rasti i Parkut të Biznesit në Drenas, për familjet e fshatit Koret-

icë e Epërme, menaxhimi i dobët i kontratës, dhe pasojat nga menaxhimi i ujërave të zeza, kanë rezultuar në koston shtesë për familjet në shtesë të vështirësimit të kushteve të jetesës. Këta banorë, nuk kishin njohuritë e duhura, por edhe kishte munguar vullneti institucional, që dëmet e tyre të kompensoheshin, apo që të gjendej një metodë për lehtësimin e jetesës së tyre.

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

351.712.2.028(047)

Investimet e arnuara / Instituti Demokratik i
Kosovës. - Prishtinë : Instituti Demokratik i
Kosovës. – 32 f. ; 22 cm.

ISBN 978-9951-745-04-8



Address: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0) 38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Web: www.kdi-kosova.org

KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni www.kdi-kosova.org

Me përkrahjen financiare të:



Fondacioni i Kosovës për Shoqëri të Hapur
Kosovo Foundation for Open Society
Kosovska Fondacija za Otvoreno Društvo

ISBN 978-9951-745-04-8



9 789951 745048